



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 19

Tiranë – E enjte, 11 shkurt 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 27.1.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, të ndryshuar.....	2037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 29.1.2016	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 1, me emërtim “Grup Depo, të reparitit ushtarak nr. 8837”, me vendndodhje në Shkozë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	2037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 77, datë 3.2.2016	Për kontributin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, me armatim, për Mbretërinë Hashemite të Jordanisë.....	2040
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 3.2.2016	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të disa sipërfaqeve të truallit funksional, brenda territorit të pronës nr. 1019, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4030, aerodromi”, me vendndodhje në Urën Vajgurore, Berat, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar.....	2040
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 79, datë 3.2.2016	Për një shtesë në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Rendit Publik”, të ndryshuar.....	2044

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 80, datë 3.2.2016	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017–2019.....	2045
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 3.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Financiare (SMBAF).....	2048
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 82, datë 3.2.2016	Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Programit të Buxhetit Afatmesëm (SPBA).....	2048
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 83, datë 3.2.2016	Për miratimin e kriterëve të krijimit të njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik.....	2050
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 84, datë 3.2.2016	Për procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik.....	2051
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 3.2.2016	Për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”	2053
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 3.2.2016	Për transferimin e së drejtës së pronësisë së shoqërisë “Qendra sportive” sh.a., Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, te Bashkia Tiranë.....	2054



VENDIM
Nr. 73, datë 27.1.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
 NË VENDIMIN NR. 27, DATË 11.1.2012, TË
 KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
 PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT
 TË FEMRAVE NGA GRUPET E
 VEÇANTA”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8, të ligjit nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 27, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në përmbajtjen e vendimit, fjala “...femrave...” zëvendësohet me fjalët “...grave dhe vajzave...”.

2. Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Shkronja “b” ndryshohet, me këtë përmbajtje:

“b) punëmarrësin e përfshirë, sipas këtij programi, deri në gjashtë paga, në masën 115 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajin e katërt, të pestë, të gjashtë e të shtatë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës. Ndërsa, për muajt e tjerë, financon punëdhënësi.”.

b) Pas shkronjës “b” shtohet shkronja “c”, me këtë përmbajtje:

“c) Punëdhënësit e rinj, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program deri në 40 për qind të numrit të punonjësve të punësuar.”.

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Përfituesit e këtij programi janë gra kryefamiljare dhe vajza nëna, të cilat kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç.”.

4. Në shkronjën “d”, të pikës 5, fjalët “...Bëjnë përjashtim nga ky rregull personat juridikë/fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por, në momentin e aplikimit në këtë program:...” zëvendësohen me fjalët “...Për personat juridikë apo fizikë, të cilët kanë detyrime ndaj organeve tatimore, por vërtetojnë

se, në momentin e aplikimit në këtë program:...”.

5. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “b”, fjalët “...numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t’u punësuar nga punëdhënësi, është jo më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona...”, zëvendësohen me fjalët “...aplikuesit janë persona fizikë...”.

b) Në shkronjën “c”, fjalët “...numri i të punësuarve dhe i atyre, që kërkohen për t’u punësuar nga punëdhënësi, është më shumë se 50 (pesëdhjetë) persona...”, zëvendësohen me fjalët “...aplikuesit janë persona juridikë...”.

6. Në pikën 14, fjalët “...zyrave përkatëse të punësimit...” zëvendësohen me fjalët “...Shërbimit Kombëtar të Punësimit...”.

7. Në pikën 16 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Punëdhënësit i vazhdohet kompensimi për periudhën e mbetur.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 75, datë 29.1.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
 MINISTRIA E MBROJTJES TË BASHKIA
 TIRANË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË
 NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI
 FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT
 TË PRONËS NR. 1, ME EMËRTIM “GRUP
 DEPO, TË REPARTIT USHTARAK NR.
 8837”, ME VENDNDODHJE NË SHKOZË,
 TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
 VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË
 KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
 MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
 TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
 SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
 PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
 MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
 NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë



22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes të Bashkia Tiranë të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje truall funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 11 699 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², brenda territorit të pronës nr. 1, me emërtim “Grup Depo, të repartit ushtarak nr. 8837”, me vendndodhje në Shkozë, Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ngritjen e një vendqëndrimi për strehimin e familjeve të komunitetit rom.

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, hiqen objektet dhe sipërfaqja truall funksional, me

sipërfaqe të përgjithshme 11 699 (njëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) m², nga truall funksional i pronës nr. 1, me emërtim “Grup Depo, të repartit ushtarak nr. 8837”, me vendndodhje në Shkozë, Tiranë.

Bashkisë Tiranë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objekteve dhe të truallit funksional të pronës, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.


Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



**Plan Vendosja e (Pronës nr.1)
Rep. Usht. nr.4451 Shkozë, Tiranë
(Objektet dhe siperfaqja që do të bëhet kalim kapital Bashkisë
Tiranë për strehimin e Komunitetit Rom)**



SHKALLA 1:1000



VENDIM

Nr. 77, datë 3.2.2016

**PËR KONTRIBUTIN E KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË, ME ARMATIM, PËR
MBRETËRINË HASHEMITE TË
JORDANISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “d”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e armatimit, pa shpërblim, Mbretërisë Hashemite të Jordanisë, të hequr nga armatimi dhe përdorimi, i tepërt dhe jashtë nevojave të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si kontribut i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në kuadër të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, sipas llojit dhe sasisë së përcaktuar në listën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

LISTA NR. 1

Armatimi që do t'i jepet Mbretërisë Hashemite të Jordanisë

Nr.	Emërtimi i armatimit	Sasia/Copë
1	Tank T-59	1 (një)
2	Tërheqës tanku T-59	1 (një)

VENDIM

Nr. 78, datë 3.2.2016

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË
SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA
E MBROJTJES TE MINISTRIA E
TRANSPORTIT DHE
INFRASTRUKTURËS, PËR
AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR,
TË DISA SIPËRFAQEVE TË TRUALLIT
FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT
TË PRONËS NR. 1019, ME EMËRTIM
“REPARTI USHTARAK NR. 4030,
AERODROMI”, ME VENDNDODHJE
NË URËN VAJGURORË, BERAT, DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË
CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të sipërfaqeve, truall funksional, (S1) prej 2 674 (dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) m², (S2) prej 4 732 (katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) m² dhe (S4) prej 1 237 (një mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 8 643 (tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) m², brenda territorit të pronës nr. 1019, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 4030, aerodromi”, me vendndodhje në Urën Vajgurore, Berat, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e rrugës kombëtare automobilistike Lushnjë-Berat.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqen sipërfaqet,



truall funksional, (S1) prej 2 674 (dy mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) m², (S2) prej 4 732 (katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) m² dhe (S4) prej 1 237 (një mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë) m², me sipërfaqe të përgjithshme 8 643 (tetë mijë e gjashtëqind e dyzet e tre) m², nga truall funksional i pronës nr. 1019, me emërtim “Repartit ushtarak nr. 4030, aerodromi”, me vendndodhje në Urën Vajgurore, Berat, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

3. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohe të ndryshojnë destinacionin e përdorimit të sipërfaqeve të pronës, të përçaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, t’i tjetërsojnë ose t’ua japin ato në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë e fluturimeve të bazës ajrore të dislokuar në pronën nr. 1019, me emërtim “Repartit ushtarak nr. 4030, aerodromi”, me vendndodhje në Urën Vajgurore, Berat, në segmentin rrugor që prek gjurma e rrugës, për ndalimin e qarkullimit në rastet e operacioneve ushtarake ajrore, Autoriteti Rrugor Shqiptar

duhet të vendosë semaforë, të ndërtojë një nënkallim për lidhjen e komunikimin me të dyja pjesët e pronës që i ndan segmenti rrugor dhe përgjatë segmentit rrugor, të mos ndërtojë asnjë vendqëndrim, si dhe të vendosë barriera anësore për të bërë të pamundur komunikimin e këmbësorëve e të mjeteve me pjesët e pronës së bazës ajrore. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, para fillimit të punimeve, të hartojë aktmarrëveshje me Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



PLAN RILEVIMI I PJESSHËM

Sip. që zë projekti i rrugës Lushnjë-Berat në pronën nr.1019, me emërtim "Rep.Usht.Nr.4030, Aerodromi", KUÇOVË

MIRATOHET

Komandanti i Forcës Ajrore
Gjeneral Brigadë Vladimir AVDIAJ





PUNOI
Topograf Nikoll TUSHI

DREJTORI I IGJIU
N/Kolonel Zydi ALCANI



IDENTIFIKIMI I PASURISE
Zona Kadastrale 3682 .
Nr.Pasurise-----Vol.----Fq-----
Indeksi i Hartes
K-34-112-(173-C),K-34-112-(173-D),
Shkalla 1: 2500
Adresa e pasurise Ura Vajgurore.
Q/F Kuçove,Ura Vajgurore.
Pronari :
Ministria e Mbrojtjes,Forca Ajrore.







VENDIM
Nr. 79, datë 3.2.2016

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10 e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet

vendimit nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet prona me emërtimin “Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit”, sipas formularit të inventarizimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

Lista që i bashkëlidhet këtij vendimi përbëhet nga 1 (një) fletë.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Qendra e Shërbimit dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Te tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

A				B				C			
Nr. Rend	Nr. Rend sipas VKM	Zona Kadastr. Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtirja Gjeografike	Komponentet perberes te Prones	Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes	Permasat e Prones ne m ²	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni/Enti perdorues. Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
				QSHAMT (ish ofcina e MB)		Rruga Irfan Tomini Tirane	9486 m ²		MPB	QSHAMT	
				Rruga Irfan Tomini Tirane	Godine 1 kat	Pike referimi	1336.4	Rep riparim vetura+furgona	MPB	QSHAMT	
					Godine 2 kat	Veri	325.2	Zyra+Magazina	MPB	QSHAMT	
					Godine 1 kat	Lindje	510	Rep Kamjonave	MPB	QSHAMT	
					Godine 1 kat	Jug - Perendim	1110.16	Repart+ magazine	MPB	QSHAMT	
					Godine 1 kat	Veri - Perendim	694.26	Rep targimit+ kovacane+dyqane	MPB	QSHAMT	
					Godine 1 kat	Jug	523	Rep Motorist	MPB	QSHAMT	



VENDIM
Nr. 80, datë 3.2.2016

**PËR MIRATIMIN E KUADRIT
MAKROEKONOMIK E FISKAL PËR
PERIUDHËN 2017–2019**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2017–2019, sipas lidhjeve nr. 1, “Treguesit kryesorë makroekonomikë”, dhe nr. 2.1 e nr. 2.2, “Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar”, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Treguesit kryesorë makroekonomik

Treguesit	Njësia	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
							Para.	Para.	Para.	Para.	Para.
Popullsia	Milion	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	2.9	3.0	3.0
Inflacioni (mesatar)	%	3.6	3.5	2.0	1.9	1.6	1.8	2.3	2.7	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	4.5	2.3	1.0	0.2	1.6	0.6	2.5	3.0	3.1	3.1
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	103.9	100.9	108.2	105.7	105.5	125.6	125.6	125.6	125.6	125.6
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	137.7	140.5	139.0	140.3	140.0	140.1	140.1	140.1	140.1	140.1
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerëse (PPP)	Lek / USD	44.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5	45.5
Rritja reale e PBB	%	3.7	2.5	1.4	1.1	2.0	2.6	3.4	3.9	4.2	4.2
PBB	Lek miliardë	1,239.6	1,300.6	1,332.8	1,350.6	1,400.5	1,444.7	1,530.5	1,637.2	1,760.2	1,891.2
PBB	USD miliardë	11.9	12.9	12.3	12.8	13.3	11.5	12.2	13.0	14.0	15.1
PBB	Euro miliard	9.0	9.3	9.6	9.6	10.0	10.3	10.9	11.7	12.6	13.5
PBB për banor	Lek mijë	425.6	447.8	459.5	466.1	483.9	496.7	523.5	557.2	596.1	637.9
PBB për banor	USD	4,094.6	4,437.5	4,247.5	4,410.7	4,587.4	3,953.0	4,166.8	4,435.0	4,744.6	5,077.4
PBB për banor	Euro	3,090.6	3,186.5	3,306.3	3,323.1	3,456.9	3,544.8	3,736.5	3,977.1	4,254.7	4,553.1
PBB për banor	USD-PPP	9,571.1	9,850.1	10,108.8	10,254.5	10,644.7	10,925.9	11,516.7	12,258.2	13,113.9	14,033.8
Norma e papunësisë	%	14.2	14.3	13.8	16.4	17.9	17.3	15.9	14.4	13.1	12.1
Të ardhurat totale	% të PBB	26.2	25.4	24.8	24.2	26.2	26.3	27.4	27.3	27.3	27.3
Shpenzimet totale	% të PBB	29.3	28.9	28.2	29.2	31.3	30.3	29.6	28.7	27.8	26.9
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.1	-3.5	-3.4	-5.0	-5.2	-4.0	-2.2	-1.4	-0.5	0.4
Bilanci primar fiskal	% të PBB	0.3	-0.4	-0.3	-1.7	-2.3	-1.4	0.6	1.5	2.4	3.2
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	2.4	1.9	1.2	-0.1	1.6	1.5	1.7	2.5	3.2	4.2
Huamarrje totale neto	% të PBB	3.1	3.5	3.5	4.1	5.0	3.6	2.2	1.4	0.5	-0.4
Borxhi Publik Total	% të PBB	57.7	59.4	62.2	70.4	71.8	72.5	70.9	67.9	63.9	59.3
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	54.0	55.7	58.2	61.7	65.9	67.4	65.9	63.0	59.1	54.6
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	3.7	3.7	4.0	8.7	5.9	5.1	5.0	4.9	4.8	4.7
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-11.3	-13.2	-10.2	-10.9	-12.9	-10.1	-10.7	-11.2	-11.0	-9.9
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-20.6	-22.8	-18.6	-18.2	-18.9	-16.5	-17.9	-17.8	-17.1	-15.4
Mallra	% të PBB	-23.1	-24.2	-20.8	-20.6	-22.1	-21.7	-23.5	-23.3	-22.6	-21.1
Eksporte	% të PBB	13.0	15.2	15.9	10.9	9.3	8.7	8.8	9.0	9.3	9.5
Importe	% të PBB	-36.1	-39.4	-36.8	-31.5	-31.5	-30.4	-32.2	-32.3	-31.9	-30.6
Bilanci i pagesave	% të PBB	2.0	-0.3	0.8	1.1	1.0	3.1	1.8	1.5	1.6	2.1

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore



Lidhja 2.1

TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

në milion Lekë

Nr.	E M E R T I M I	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
							I Pritshmi	PBA	PBA	PBA	PBA
TOTALI TË ARDHURAVE		324,721	330,469	330,384	327,178	366,686	379,246	418,894	446,776	480,413	516,401
I.	Ndihmat	4,605	3,811	5,559	5,737	10,092	9,800	13,000	15,100	15,800	16,200
	<i>nga të cilat: mbështetje buxhetore nga KE</i>						5,000	3,300	3,300	3,000	3,000
II.1	Të ardhura tatimore	288,564	303,927	300,862	299,888	335,921	343,946	377,214	405,746	436,233	469,801
II.1.1	Nga tatimet dhe doganat	223,019	235,509	232,591	229,031	253,534	259,247	282,211	304,812	328,369	355,184
1	<i>Tatimi mbi vlerën e shtuar</i>	113,998	119,189	116,533	111,940	123,847	125,562	137,916	147,035	157,928	169,291
2	<i>Tatimi mbi fitimin</i>	17,606	19,712	16,853	15,119	21,483	24,963	24,314	26,507	31,336	36,529
3	<i>Akczat</i>	38,788	40,403	36,421	38,151	40,894	39,027	44,653	49,625	52,010	55,726
4	<i>Tatimi mbi të ardhurat personale</i>	27,058	27,967	27,989	29,570	28,852	29,270	32,073	35,509	37,691	40,892
5	<i>Taksa nacionale dhe të tjera</i>	18,295	21,388	28,677	28,454	32,606	34,527	37,219	40,099	43,169	46,259
6	<i>Taksa doganore</i>	7,274	6,850	6,118	5,797	5,852	5,898	6,036	6,036	6,236	6,318
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	11,898	11,791	10,859	10,825	12,447	11,700	16,502	19,748	21,376	21,915
1	<i>Taksa lokale</i>	7,684	7,279	6,210	6,396	7,060	5,746	10,976	11,404	11,746	12,099
2	<i>Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)</i>	1,896	1,942	2,506	2,454	3,678	3,921	5,260	8,044	9,330	9,517
3	<i>Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël</i>	2,318	2,570	2,143	1,975	1,709	2,033	266	300	300	300
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	53,647	56,627	57,411	60,033	69,940	72,999	78,501	81,185	86,487	92,702
1	<i>Sigurimi shoqëror</i>	45,041	48,839	49,533	51,064	61,426	60,829	66,871	69,295	73,988	79,038
2	<i>Sigurimi shëndetësor</i>	6,432	6,152	6,590	7,410	8,199	10,187	10,630	10,891	11,500	12,665
3	<i>Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve</i>	2,174	1,636	1,288	1,559	315	1,983	1,000	1,000	1,000	1,000
III.	Të ardhura jo-tatimore	31,552	22,731	23,963	21,553	20,673	25,500	28,680	25,930	28,380	30,400
1	<i>Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë</i>	4,936	5,710	4,693	4,628	1,951	962	1,000	1,000	1,000	1,500
2	<i>Të ardhura nga institucionet buxhetore, nga të cilat:</i>	13,994	10,336	10,276	9,987	11,152	15,027	15,500	16,800	19,300	21,220
	<i>Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë</i>						3,800	4,183	4,500	4,700	5,000
	<i>Të ardhura jo-tatimore të pushtetit vendor</i>						2,600	2,700	2,800	2,800	2,800
	<i>Të tjera të ardhura nga inst. buxh për qev. qendrore</i>						8,627	8,617	9,500	11,800	13,200
3	<i>Dividentit</i>	735	1,060	426	943	1,387	2,011	5,000	800	800	400
4	<i>Tarifat shërbimeve</i>	2,977	3,510	3,772	3,133	3,171	3,400	3,400	3,500	3,400	3,400
5	<i>Të tjera, nga të cilat:</i>	8,910	2,115	4,797	2,862	3,012	4,100	3,780	3,830	3,880	3,880
	<i>Jashtë limitit</i>						1,760	1,850	1,900	1,900	1,900
	<i>Të tjera (të rastësishme)</i>	498	615	2,297			1,250	1,300	1,330	1,380	1,380
TOTALI I SHPENZIMEVE		362,752	376,300	376,241	394,118	438,820	437,473	453,325	469,788	489,033	508,543
I.	Shpenzime Korrente	300,878	305,621	312,585	328,641	341,328	352,780	385,337	396,471	413,748	427,404
I.1	Personeli	65,762	67,446	69,437	70,716	71,367	72,488	71,286	72,551	73,560	75,100
1	<i>Paga</i>	56,951	58,398	60,144	61,087	61,416	62,491	60,982	60,930	61,360	62,200
2	<i>Kontributi për sigurime shoqërore</i>	8,811	9,048	9,293	9,629	9,951	9,997	9,904	10,121	10,200	10,400
3	<i>Fondi i veçantë i pagave</i>							400	500	500	500
4	<i>Politika të reja pagash</i>							1,000	1,500	2,000	2,000
I.2	Interesat	41,604	41,121	41,498	43,335	40,075	38,643	43,000	47,954	51,083	52,382
1	<i>Të brendshme</i>	35,583	34,253	34,005	35,890	31,834	27,385	30,875	35,282	38,437	40,363
2	<i>Të huaja</i>	6,021	6,868	7,492	7,445	8,241	11,258	12,125	12,672	12,646	12,019
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje, nga të cilat:	34,318	32,995	31,470	32,424	31,341	42,632	43,638	43,922	45,706	47,012
1	<i>Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)</i>						38,072	38,788	39,022	40,806	42,112
2	<i>Arsim i lartë</i>						2,800	3,000	3,000	3,000	3,000
3	<i>Të tjera jashtë limitit</i>						1,760	1,850	1,900	1,900	1,900
I.4	Subvencionat	3,535	3,301	1,884	1,574	1,599	1,760	1,750	1,600	1,600	1,600
I.5	Shpenzime për fondet speciale	106,207	113,894	120,269	127,644	138,534	142,500	152,593	161,109	171,400	180,400
1	<i>Sigurime shoqërore</i>	79,316	85,265	89,860	95,598	101,483	107,486	113,349	119,609	127,400	133,500
2	<i>Politika të reja pensionesh</i>										1,400
3	<i>Sigurime shëndetësore</i>	25,141	26,974	28,828	30,147	35,734	38,814	36,244	37,500	39,000	40,500
4	<i>Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve</i>	1,750	1,655	1,581	1,899	1,317	1,200	3,000	4,000	5,000	5,000
I.6	Buxheti lokal	30,764	28,119	27,333	29,787	32,892	33,834	49,569	45,835	46,799	47,209
1	<i>Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor</i>	18,866	16,328	16,474	18,962	20,445	11,455	13,000	10,837	11,173	12,044
2	<i>Granti specifik nga Buxheti i Shtetit</i>							7,917	6,000	6,000	6,000
3	<i>Grante konkurrese/Fondi i Zhvillimit Rajonal nga B.Shtetit</i>						7,679	9,000	6,000	5,000	4,000
4	<i>Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)</i>	11,898	11,791	10,859	10,825	12,447	11,700	16,502	19,748	21,376	21,915
5	<i>Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)</i>						400	450	450	450	450
6	<i>Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)</i>						2,600	2,700	2,800	2,800	2,800
I.7	Transferat të tjera	1,882	1,876	984	800	912	20,923	23,500	23,500	23,600	23,700
1	<i>Pagosa e paguara në përparim</i>	1,460	2,539	490	3,399	3,975	615	1,000	1,000	1,000	1,000
2	<i>Ndihma ekonomike</i>	16,706	16,369	18,011	19,370	22,849	18,339	20,500	20,500	20,500	20,500
3	<i>Kompensim për të përndjekurit politikë</i>	1,000	1,500	1,699	2,991	1,759	1,968	2,000	2,000	2,100	2,200
II.	Fondi rezervë							3,000	4,000	4,000	4,500
1	<i>Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave</i>							1,000	1,000	1,500	1,500
2	<i>Fond kontigjencë për rruajtjen e deficitit</i>							2,000	3,000	3,000	3,000
III.	Shpenzime kapitale	67,492	70,679	61,656	65,477	60,541	62,230	59,988	64,317	65,785	71,639
1	<i>Financimi i brendshëm</i>	46,642	41,097	27,398	36,701	33,755	36,079	30,436	31,777	31,425	36,477
3	<i>Arsim i lartë nga të ardhurat e veta</i>						1,000	1,183	1,500	1,700	2,000
4	<i>Financimi i huaj</i>	20,850	27,982	34,257	28,776	26,786	25,151	28,369	31,040	32,660	33,162
IV.	Detyrimet e prapambetura						33,782	17,300			
V.	Të tjera	-5,618	0	2,000	0	1,669	1,000	5,000	5,000	5,000	5,000
3	<i>Huadhënie neto (sistemi energjitik, etj)</i>	-5,618	0	2,000	0	1,500	1,000	5,000	5,000	5,000	5,000
VI.	Fond shpronësimi						1,500	4,163			
DEFICITI		-38,031	-45,831	-45,857	-66,940	-72,134	-58,227	-34,431	-23,012	-8,620	7,859
FINANCIMI DEFICITIT		38,031	45,831	45,857	66,940	72,134	58,227	34,431	23,012	8,620	7,859
I.	I brendshëm	13,155	26,073	26,495	56,129	42,222	-10,542	20,979	29,992	19,197	5,707
1	<i>Të ardhura nga privatizimi</i>	411	438	1,221	16,703	35	810	0	0	0	0
3	<i>Hua-marrje e brendshme (neto)</i>	11,284	28,175	24,783	46,298	38,212	-17,352	20,979	29,992	19,197	5,707
4	<i>Të tjera</i>	1,460	-2,539	490	-3,399	3,975	6,000	0	0	0	0
II.	I huaj	24,876	19,758	19,362	10,811	29,912	68,769	13,452	-6,980	-10,577	-13,566
1	<i>Hua afatgjatë (e marrë)</i>	59,793	25,229	32,257	22,354	19,148	118,699	25,369	24,240		



TREGUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

në % të PBB

Nr.	E M È R T I M I	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
							I Pritshmi	PBA	PBA	PBA	PBA
TOTALI TË ARDHURAVE		26.2	25.4	24.8	24.2	26.2	26.3	27.4	27.3	27.3	27.3
I.	Ndihmat	0.4	0.3	0.4	0.4	0.7	0.7	0.8	0.9	0.9	0.9
	<i>nga të cilat: mbështetje buxhetore nga KE</i>						0.0	0.3	0.2	0.2	0.2
II.	Të ardhura tatimore	23.3	23.4	22.6	22.2	24.0	23.8	24.6	24.8	24.8	24.8
II.1	Nga tatimet dhe doganat	18.0	18.1	17.5	17.0	18.1	17.9	18.4	18.6	18.7	18.8
✓ 1	Tatimi mbi vlerën e shtuar	9.2	9.2	8.7	8.3	8.8	8.7	9.0	9.0	9.0	9.0
✓ 2	Tatimi mbi fitimin	1.4	1.5	1.3	1.1	1.5	1.7	1.6	1.6	1.8	1.9
✓ 3	Akczat	3.1	3.1	2.7	2.8	2.9	2.7	2.9	3.0	3.0	2.9
✓ 4	Tatimi mbi të ardhurat personale	2.2	2.2	2.1	2.2	2.1	2.0	2.1	2.2	2.1	2.2
✓ 5	Taksa nacionale dhe të tjera	1.5	1.6	2.2	2.1	2.3	2.4	2.4	2.4	2.5	2.5
6	Taksa doganore	0.6	0.5	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.3
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	1.0	0.9	0.8	0.8	0.9	0.8	1.1	1.2	1.2	1.2
✓ 1	Taksa lokale	0.6	0.6	0.5	0.5	0.5	0.4	0.7	0.7	0.7	0.6
✓ 2	Tatimi mbi pasurinë (ndërtesat)	0.2	0.1	0.2	0.2	0.3	0.3	0.3	0.5	0.5	0.5
✓ 3	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	0.2	0.2	0.2	0.1	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	4.3	4.4	4.3	4.4	5.0	5.1	5.1	5.0	4.9	4.9
✓ 1	Sigurimi shoqëror	3.6	3.8	3.7	3.8	4.4	4.2	4.4	4.2	4.2	4.2
✓ 2	Sigurimi shëndetësor	0.5	0.5	0.5	0.5	0.6	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
3	Të ardhurat për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.2	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
III.	Të ardhura jo-tatimore	2.5	1.7	1.8	1.6	1.5	1.8	1.9	1.6	1.6	1.6
1	Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë	0.4	0.4	0.4	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
✓ 2	Të ardhura nga institucionet buxhetore, nga të cilat:	1.1	0.8	0.8	0.7	0.8	1.0	1.0	1.0	1.1	1.1
	Të ardhura nga sistemi i arsimit të lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.3	0.3	0.3	0.3	0.3
	Të ardhura jo-tatimore të pushtetit vendor	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.1
	Të tjera të ardhura nga inst. buxh për qev. qendrore	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.6	0.6	0.6	0.7	0.7
✓ 3	Dividenti	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.3	0.0	0.0	0.0
✓ 4	Tarifat shërbimeve	0.2	0.3	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
✓ 5	Të tjera, nga të cilat:	0.7	0.2	0.4	0.2	0.2	0.3	0.2	0.2	0.2	0.2
	Jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	Të tjera (të rastësishme)	0.0	0.0	0.2	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
TOTALI I SHPENZIMEVE		29.3	28.9	28.2	29.2	31.3	30.3	29.6	28.7	27.8	26.9
I.	Shpenzime Korrente	24.3	23.5	23.5	24.3	24.4	24.4	25.2	24.2	23.5	22.6
I.1	Personeli	5.3	5.2	5.2	5.2	5.1	5.0	4.7	4.4	4.2	4.0
✓ 1	Paga	4.6	4.5	4.5	4.5	4.4	4.3	4.0	3.7	3.5	3.3
✓ 2	Kontributi për sigurime shoqërore	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7	0.6	0.6	0.6	0.5
✓ 3	Fondi i veçantë i pagave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
4	Politika të reja pagash	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1
I.2	Interesat	3.4	3.2	3.1	3.2	2.9	2.7	2.8	2.9	2.9	2.8
1	Të brendshme	2.9	2.6	2.6	2.7	2.3	1.9	2.0	2.2	2.2	2.1
2	Të huaja	0.5	0.5	0.6	0.6	0.6	0.8	0.8	0.8	0.7	0.6
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje, nga të cilat:	2.8	2.5	2.4	2.4	2.2	3.0	2.9	2.7	2.6	2.5
1	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	2.6	2.5	2.4	2.3	2.2
2	Arsim i lartë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
3	Të tjera jashtë limitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.3	0.3	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	8.6	8.8	9.0	9.5	9.9	9.9	10.0	9.8	9.7	9.5
1	Sigurime shoqërore	6.4	6.6	6.7	7.1	7.2	7.4	7.4	7.3	7.2	7.1
2	Politika të reja pensionesh	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1
3	Sigurime shëndetësore	2.0	2.1	2.2	2.2	2.6	2.3	2.4	2.3	2.2	2.1
4	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.2	0.3	0.3
I.6	Buxheti lokal	2.5	2.2	2.1	2.2	2.3	2.3	3.2	2.8	2.7	2.5
1	Granti nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	1.5	1.3	1.2	1.4	1.5	0.8	0.8	0.7	0.6	0.6
2	Granti specifik	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	0.4	0.3	0.3
3	Grante konkurrese/Fondi i Zhvillimit Rajonal nga B.Shtetit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.5	0.6	0.4	0.3	0.2
4	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	1.0	0.9	0.8	0.8	0.9	0.8	1.1	1.2	1.2	1.2
5	Buxheti lokal (të ardhurat nga transferimi i rentës)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
6	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.2	0.2	0.1
I.7	Transferta të tjera	1.5	1.4	1.6	1.7	1.8	1.4	1.5	1.4	1.3	1.3
1	Pagesa e papunësisë	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Ndihma ekonomike	1.3	1.3	1.4	1.4	1.6	1.3	1.3	1.3	1.2	1.1
3	Kompensim për të përdjekurit politikë	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.2	0.2	0.3	0.2
1	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
2	Fond kontigjencë për ruajtjen e deficitit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.2	0.2	0.2
III.	Shpenzime kapitale	5.4	5.4	4.6	4.8	4.3	4.3	3.9	3.9	3.7	3.8
1	Financimi i brendshëm	3.8	3.2	2.1	2.7	2.4	2.5	2.0	1.9	1.8	1.9
3	Arsim i lartë nga të ardhurat e veta	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
4	Financimi i huaj	1.7	2.2	2.6	2.1	1.9	1.7	1.9	1.9	1.9	1.8
IV.	Detyrimet e prapambetura	0.0	0.0	0.0	0.0	2.4	1.2				
V.	Të tjera	-0.5	0.0	0.2	0.0	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3
3	Huadhënie neto (sistemi energjistik, etj)	-0.5	0.0	0.2	0.0	0.1	0.1	0.3	0.3	0.3	0.3
VI.	Fond shpronësimit						0.3				
DEFIÇITI		-3.1	-3.5	-3.4	-5.0	-5.2	-4.0	-2.2	-1.4	-0.5	0.4
FINANCIMI DEFIÇITIT		3.1	3.5	3.4	5.0	5.2	4.0	2.2	1.4	0.5	0.4
I.	I brendshëm	1.1	2.0	2.0	4.2	3.0	-0.7	1.4	1.8	1.1	0.3
1	Të ardhura nga privatizimi	0.0	0.0	0.1	1.2	0.0	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Hua-marrje e brendshme (neto)	0.9	2.2	1.9	3.4	2.7	-1.2	1.4	1.8	1.1	0.3
4	Të tjera	0.1	-0.2	0.0	-0.3	0.3	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0
II.	I huaj	2.0	1.5	1.5	0.8	2.1	4.8	0.9	-0.4	-0.6	-0.7
1	Hua afatgjatë (e marrë)	4.8	1.9	2.4	1.7	1.4	8.2	1.7	1.5	1.4	1.3
2	Ndryshimi i gjendjes së arkës	-0.1	0.2	-0.2	0.1	-0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
3	Ripagesat	-2.7	-0.6	-0.8	-0.9	-1.3	-4.4	-1.7	-1.9	-2.0	-2.0
4	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB)	0.0	0.0	0.0	0.0	2.2	1.0	0.9	0.0	0.0	0.0
MEMO:											
Balanca e përgjithshme (deficitit përgjithshëm)		-3.1	-3.5	-3.4	-5.0	-5.2	-4.0	-2.2	-1.4	-0.5	0.4
Investime publike totale (shp. kapitale + FZR + sek. Energjise)		5.0	5.4	4.8	4.8	4.4	4.9	4.8	4.6	4.3	4.3
Balanca korente		1.9	1.9	1.3	-0.1	-0.7	0.9	2.6	3.2	3.8	4.7
Balanca primare		0.3	-0.4	-0.3	-1.7	-2.3	-1.4	0.6	1.5	2.4	3.2
Borxhi Publik Total (Stok)		57.7	59.4	62.1	70.4	71.8	72.5	70.9	67.9	63.9	59.3
I.	Borxhi publik nga buxheti (stok)	54.0	55.7	58.1	61.7	65.9	67.4				



VENDIM

Nr. 81, datë 3.2.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË
SISTEMIT TË MENAXHIMIT TË
BORXHIT DHE ANALIZËS
FINANCIARE (SMBAF)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Borxhit dhe Analizës Financiare (SMBAF), i cili përmban të dhëna për kreditorin, huamarrësin, termat dhe kushtet financiare për çdo kredi dhe letër me vlerë, shtetërore e të garantuar, sektorin për të cilin shpërndahen fondet e kredisë/letrës me vlerë, si dhe kurset e këmbimit. Sistemi pasqyron të dhëna faktike dhe kryen parashikime në përputhje me termat financiarë të marrëveshjeve përkatëse.

2. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

3. Të dhënat që përmban sistemi janë vetëm të dhëna parësore, pasi ai nuk merr të dhëna nga sisteme të tjera. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e gjeneruara nga SMBAF-i dhe që kanë të bëjnë me:

- a) informacion për huadhënësin;
- b) huamarrësin;
- c) termat dhe kushtet e kredisë/letrës me vlerë;
- ç) disbursimet;
- d) shërbimet e borxhit;
- dh) kurset e këmbimit.

Sistemi bën të mundur prodhimin e raporteve të ndryshme mbi borxhin e jashtëm.

4. Subjekti përgjegjës për administrimin e sistemit SMBAF është Ministria e Financave.

5. Dhënës i informacionit për sistemin është Ministria e Financave.

6. Subjekte të interesuara janë:

- a) Ministria e Financave;
- b) Banka e Shqipërisë;

Faqe | 2048

- c) Banka Botërore;
- ç) Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN);
- D) EUROSTAT-i;
- dh) agjencitë e *Credit Ratings*;
- e) ministritë e linjës/insitucione që zbatojnë projekte që financohen me kredi të huaja etj.

7. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SMBAF-it është, si më poshtë vijon:

a) **Regjistrues:** regjistron informacion për marrëveshjet e kredive, kreditorët, huamarrësit, disbursimet, pagesat, kurset e këmbimit, normat e interesit etj.;

b) **Përdorues vetëm lexues:** kjo kategori përdoruesish nuk është e lejuar të regjistrojë informacion në sistem. Përdoruesit e kësaj kategorie mund të ekzekutojnë vetëm raporte dhe t'i përdorin ato për qëllime raportimi;

c) **Administratorët e sistemit:** administratorët e sistemit janë administratorë teknikë, të cilët mirëmbajnë e administrojnë teknikut sistemin dhe përdoruesit e sistemit SMBAF.

8. Ministria e Financave ka të drejta administrative mbi SMBAF-in, në rolet:

- a) Administrator;
- b) Raportues;
- c) Auditues.

9. Baza e të dhënave të SMBAF-it nuk ndërvepron me baza të tjera të dhënash.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

VENDIM

Nr. 82, datë 3.2.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS SË TË
DHËNAVE SHTETËRORE TË
SISTEMIT TË PROGRAMIT TË
BUXHETIT AFATMESËM (SPBA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Programit të Buxhetit Afatmesëm (SPBA).

2. Sistemi i Programit i Buxhetit Afatmesëm (SPBA) përmban:

a) deklaratën e misionit dhe strukturën e programeve;

b) deklaratën e politikës së programit;

c) rishikimin e politikës së programit;

ç) tavanet përgatitore të SPBA-së;

d) shpërndarjen e taveve për programet;

dh) shpërndarjen e buxhetit për vitin korrent, produkte shtesë dhe monitorimi;

e) shpenzimet e ministrisë, sipas programeve;

ë) shpenzimet e programit, sipas artikujve;

f) shpenzimet e programit, sipas produkteve;

g) menaxhimin e projekteve të investimeve;

gj) faktorët e modifikimit të çmimit;

h) të dhëna për raporte dhe statistika.

3. Përbërësit e arkitekturës *software* dhe *hardware* të sistemit miratohen nga Autoriteti Rregullator Koordinues.

4. Të dhënat që përmban sistemi ndahen në të dhëna parësore dhe dytësore, si më poshtë vijon:

a) Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e gjeneruara nga SPBA-ja dhe që kanë të bëjnë me:

- kodet e projekteve;

- kodet e programeve;

- kodet e kapitujve;

- nivelet e programeve;

- nivelet e funksioneve;

- nivelet e burimeve të fondeve;

- faktorët e modifikimit të çmimeve;

- nivelet e projekteve;

- tavanet buxhetore;

- buxhetin e planifikuar për vitin korrent;

- buxhetin e planifikuar për dy vitet e ardhshme;

- planifikimin e produkteve, aktiviteteve dhe *output*-eve.

b) Të dhëna dytësore konsiderohen ato që kanë të bëjnë me të dhëna referenciale të sistemit SIFQ, si:

- kodet e institucioneve;

- kodet e ministrive të linjës;

- kodet e llogarive ekonomike;

- kodet e entiteteve qeverisëse;

- kodet e nënllogarive;

- kodet e degëve të thesarit.

5. Subjektet përgjegjëse të SPBA-së janë, si më poshtë vijon:

a) Institucioni administrues i SPBA-së është Ministria e Financave;

b) Institucionet, palë të interesuara, janë: Kryeministria, Ministria e Financave, ministritë e linjës, institucionet qendrore buxhetore;

6. Dhënës të informacionit për SPBA-në, janë:

a) Ministria e Financave;

b) ministritë e linjës;

c) institucionet qendrore buxhetore: Presidenca, Kuvendi, Kryeministria, Shërbimi Informativ Shtetëror, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Akademia e Shkencës, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, Gjykata Kushtetuese, Agjencia Telegrafike Shqiptare, Instituti i Statistikës, Shkolla e Magjistraturës, Qendra Kombëtare e Kinematografisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Autoriteti i Konkurrencës, Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Drejtoria Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Agjencia e Prokurimit Publik, Komiteti Shtetëror i Minoriteteve, Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit, Komisioni i Prokurimit Publik, Inspektorati Qendror, Sekretariati i Ujit, Agjencia e Zbatimit të Reformës Territoriale, Agjencia e Menaxhimit të Qendrave për Hapje dhe Dialog, Agjencia Kombëtare për Zhvillimin Rajonal, agjencitë e zhvillimit rajonal, Agjencia e Zhvillimit Ekonomik Rajonal, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit, Autoriteti për të Drejtën e Informimit.

7. Subjekte të interesuara për SPBA-në, janë:

a) Kryeministria;

b) Ministria e Financave;

c) ministritë e linjës;

ç) institucionet qendrore buxhetore, të përmendura në shkronjën “c”, të pikës 6, më sipër.

d) çdo subjekt tjetër, i përcaktuar, shprehi-misht, me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Niveli i aksesit në sistemin dhe në bazën e të dhënave të SPBA-së, është:



a) administratorët e SPBA-së kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SPBA, dhe ata ndahen në dy grupe: administratorë teknikë dhe administratorë funksionalë.

- Administratorët teknikë kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi të të dhënave në SPBA, në lidhje me menaxhimin e përdoruesve të Ministrisë së Financave, ministrive të linjës dhe disa institucioneve specifike buxhetore;

- Administratorët funksionalë kanë të drejtë leximi, shkrimi dhe modifikimi, në lidhje me regjistrimin e të dhënave bazë për përgatitjen e sistemit, si:

- ndarjen e buxhetit të vitit korrent sipas ministrisë (Grupit), programit (Titullit) dhe artikullit;

- tavanet përgatitore të SPBA-së për tri vitet e ardhshme fiskale të miratuara nga Këshilli i Ministrave;

- faktorët e modifikimit të çmimit për tri vitet e SPBA-së së ardhshme.

b) ministrinë e linjës dhe Ministria e Financave kanë të drejtë përdorimi të SPBA-së, të ndarë në tri profile, si më poshtë:

- profili që përcakton tavanet e buxhetit në çdo ministri linje;

- profili që ka të drejtë të aprovojë të dhënat e hedhura në sistem, të punojë me projektet, shpenzimet dhe aktivitetet e ministrisë, të cilës i përkasin;

- profili që ka të drejtë vetëm të lexojë të dhënat në sistem, për çdo program që u është përcaktuar.

c) Kryeministria ka të drejtë leximi për buxhetin e shtetit të regjistruar në SPBA nga ministrinë e linjës;

ç) Ministria e Financave ka të drejta administrative mbi SPBA-në, në rolet:

i) administrator;

ii) raportues;

iii) auditues;

iv) zhvillues.

9. Baza e të dhënave e SPBA-së nuk ndërvepron me baza të tjera të dhënash.

10. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 83, datë 3.2.2016

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË KRIJIMIT TË NJËSIVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË SEKTORIN PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 26, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Njësitë e auditimit të brendshëm krijohen në:

a) ministrinë e linjës, institucionet e varësisë të organizuara me degë territoriale dhe bashkitë;

b) çdo institucion tjetër që kryen funksione publike, shoqëritë tregtare, organizatat jofitimprurëse dhe autoritetet e përbashkëta, të cilat zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjithshme, si dhe njësi të tjera që shpenzojnë fonde publike sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, të cilat kanë në vit, njëkohësisht jo më pak se 400 000 000 (katërqind milionë) lekë të ardhura financiare dhe 300 punonjës, përgjatë 3 (tri) viteve të fundit të veprimtarisë së tyre, me përjashtim të rasteve kur ngritja e njësisë së auditimit të brendshëm parashikohet nga një ligj i veçantë.

2. Organizimi i njësive të auditimit të brendshëm në nivel sektori apo drejtorie bëhet në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë së njësisë publike, si dhe në mbështetje të dispozitave të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e adminis-tratës shtetërore”.

3. Njësia e auditimit të brendshëm përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e njësisë. Në strukturën e njësisë së auditimit të brendshëm mund të punësohen deri në 1/3 e punonjësve të pacertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik.

4. Njësitë publike, që krijojnë njësinë e auditimit të brendshëm, sipas pikës 1, të këtij vendimi, nuk programojnë të kryejnë shërbimin e auditimit të brendshëm për njësitë e varësisë, të cilat kanë në strukturën e tyre organizative njësi të auditimit të brendshëm.



5. Në njësitë publike, të cilat kanë varësi nga dy ose më shumë institucione dhe nuk kanë të krijuar njësinë e auditimit të brendshëm, shërbimi i auditimit të brendshëm kryhet nga institucioni në fushën e përgjegjesisë shtetërore të të cilit bën pjesë njësi publike.

6. Njësitë publike, të cilat nuk plotësojnë kriteret për krijimin e njërive të auditimit sipas pikës 1, të këtij vendimi, dhe nuk kanë varësi nga ndonjë organ epror, e sigurojnë shërbimin e auditimit të brendshëm, nëpërmjet:

a) marrëveshjes midis titullarëve të njërive publike përkatëse, të cilat kanë njësi të auditimit të brendshëm dhe kapacitetet e nevojshme për të marrë përsipër kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm. Kjo marrëveshje miratohet paraprakisht nga ministri i Financave;

b) kontraktimit të personave fizikë ose juridikë, të certifikuar si “auditues të brendshëm”, i cili kryhet vetëm në rastet kur është i pamundur krijimi i shërbimit të auditimit sipas formave të tjera të parashikuara në nenin 10, të ligjit nr. 114/2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Njësi publike, për sigurimin e shërbimit të auditimit të brendshëm me kontraktim, duhet të planifikojë një fond që nuk duhet të jetë më shumë se 30% e pagës mesatare vjetore të një punonjësi, të njëjtë me nivelin e pagës së audituesit në sektorin publik.

Titullari i njësisë publike duhet të njoftojë ministrin e Financave, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e kontraktimit të shërbimeve të auditimit të brendshëm, dhe të raportojë për përfundimin e misionit të auditimit.

7. Njësitë publike, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, të kryejnë organizimin e brendshëm të strukturave organizative për njësitë e auditimit të brendshëm.

8. Vendimi nr. 212, datë 30.3.2012, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njërive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, shfuqizohet.

9. Ngarkohen ministri i Financave dhe titullarët e njërive publike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 84, datë 3.2.2016

PËR PROCEDURAT E PËRZGJEDHJES DHE TË SHPËRBLIMIT TË EKSPERTËVE TË JASHTËM, PUNONJËS TË ADMINISTRATËS PUBLIKE APO JASHTË SAJ, TË CILËT DO TË ANGAZHohen NË KRYERJEN E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 112/2015, “Për inspektimin financiar publik”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për kryerjen e inspektimit financiar publik, në rastet e mungesës së burimeve njerëzore nga njësi përgjegjëse për inspektimin financiar publik në Ministrinë e Financave, si dhe të mbulimit të fushave specifike të inspektimit financiar publik, me vendim të Nëpunësit të Parë Autorizues angazhohen ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj.

2. Kriteret që duhet të plotësojë eksperti, punonjës i administratës publike, për t’u përzgjedhur inspektor financiar publik, janë:

a) Të jetë i pajisur të paktën me diplomë universitare “Master i shkencave” ose ekuivalente me të;

b) Të ketë të paktën 5 (pesë) vite përvojë profesionale në njësitë publike.

3. Nuk mund të angazhohen për inspektim financiar publik ekspertët, punonjës të administratës publike, që ushtrojnë funksionet e titullarit të njësisë publike, nëpunësit autorizues, gjyqtarit, prokurorit, oficerit të policisë gjyqësore, audituesit të brendshëm dhe punonjësit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Kriteret që duhet të plotësojë eksperti i jashtëm i administratës publike për t’u përzgjedhur inspektor financiar publik, janë:

a) Të jetë i pajisur të paktën me diplomë universitare “Master i shkencave” ose ekuivalente me të;

b) Të jetë i pajisur me licencë dhe/ose certifikatë profesionale në fushën përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon profesionin përkatës;



c) Të jetë i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe të ketë status aktiv;

ç) Të mos ketë detyrime të papaguara fiskale dhe të sigurimeve shoqërore;

d) Të mos jetë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

5. Në rastet e angazhimit të ekspertëve jashtë administratës publike në inspektim financiar publik, përpara caktimit, njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik kërkon prej tyre:

a) Një dokument që vërteton se ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit;

b) Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata, që nuk është në ndjekje penale, lëshuar muajin e fundit.

6. Kandidatët, që aplikojnë për t'u përzgjedhur në listën e inspektorëve financiarë publikë, duhet të paraqesin në Ministrinë e Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën me shkrim;

b) Fotokopjen e kartës së identitetit;

c) Të dhëna për adresën e vendbanimit, vendin e punës dhe pikat e kontaktit;

ç) Kopje të diplomës, listës së notave dhe një përmbledhje të edukimit, kualifikimeve dhe eksperiencës së punës;

d) Një fotografi të përmasave 4 x 6;

dh) Kopje të licencave dhe/ose certifikatave profesionale në fusha dhe profesione të rregulluara me ligj;

e) Dëshmi dhe certifikata të trajnimeve e të kualifikimeve pasuniversitare;

ë) Vërtetimin nga qendra e punës për funksionin që kryen dhe lejimin në rast angazhimi, kur aplikanti është punonjës i administratës publike;

f) Numrin unik të identifikimit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, si dhe një kopje të ekstraktit historik, në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike;

g) Një dokument që vërteton se aplikanti ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga administrata tatimore për tre muajt e fundit, në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike;

gj) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore në rast se aplikanti është punonjës jashtë administratës publike.

7. Për raste të veçanta, kur gjatë shërbimit të inspektimit financiar publik kërkohet akses në informacionin e klasifikuar në bazë të kuadrit ligjor në fuqi, inspektori financiar publik, përpara angazhimit në inspektim financiar, pajiset me certifikatën e sigurisë nga institucionet përkatëse.

8. Përzgjedhja e inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, kryhet nga një komision i ngritur me urdhër të ministrit të Financave, i cili ka për detyrë të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur dhe të hartojë listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, të cilën ia paraqet për miratim ministrit të Financave.

9. Datat e shpalljes së përzgjedhjes së inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, afati dhe procedurat e aplikimit caktohen me urdhër të ministrit të Financave.

10. Inspektorët financiarë publikë, ekspertë, punonjës të administratës publike, janë të detyruar të angazhohen në misione inspektimi financiare publike, në çdo kohë dhe pa u penguar nga eprorët apo drejtuesit e institucioneve respektive. Për mospërmbushjen e këtij detyrimi apo pengimin në angazhimin e kërkuar, nëpunësi i parë autorizues informon drejtuesin e institucionit ku është i punësuar punonjësi, i cili shqyrton rastin në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhënien e punës ku është i punësuar punonjësi.

11. Inspektori financiar publik, ekspert i jashtëm, punonjës i administratës publike apo jashtë saj, për periudhën e angazhimit të tij në kryerjen e inspektimit financiar publik trajtohet financiarisht. Ky trajtim jepet i diferencuar, si më poshtë vijon:

a) Për inspektorin financiar publik, që është ekspert, punonjës i administratës publike, trajtimi financiar përfshin, krahas pagës mujore të tij, edhe shpërblimin në masën 5 000 (pesë mijë) lekë në ditë.

b) Inspektori financiar publik, që është ekspert jashtë administratës publike, shpërblehet në masën 7 000 (shtatë mijë) lekë në ditë.



c) Në rastet kur inspektori financiar publik, ekspert i jashtëm, punonjës i administratës publike apo jashtë saj, dërgohet për inspektim jashtë qendrës së tij të punës, ai trajtohet edhe me dietë, sipas kriteve të përcaktuara në aktet nënligjore në fuqi.

12. Nëpunësi i Parë Autorizues, në rastet e angazhimit në inspektim të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, me propozimin e drejtuesit të njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, përcakton emrat e inspektorëve financiarë publikë dhe kohëzgjatjen e inspektimit financiar publik në përputhje me vështirësinë dhe volumin e punës. Fillimisht angazhohen inspektorët financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike, dhe, në mungesë të tyre, inspektorët financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës jashtë administratës publike.

13. Shpërblimi i inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, sipas pikës 11, të këtij vendimi, kryhet me miratimin e Nëpunësit të Parë Autorizues.

14. Efektet financiare, që rrjedhin nga kostoja e angazhimit të inspektorëve financiarë publikë, ekspertë të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin vjetor të Ministrisë së Financave.

15. Vendimi nr. 492, datë 6.7.2011, i Këshillit të Ministrave, “Për shpërblimin e inspektorit financiar publik”, shfuqizohet.

16. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 85, datë 3.2.2016

PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR “CMT, SHTUTGART 2017”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të

ndryshuar, dhe të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”, që do të mbahet nga data 10 deri në 22 janar 2017, si “vend partner”.

2. Në këtë panair Shqipëria përfaqësohet nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit (AKT).

3. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Turizmit për menaxhimin dhe administrimin e projektit “CMT, Shtutgart 2017” dhe të veprimeve financiare.

4. Autorizohet drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit për nënshkrimin e kontratës së pjesëmarrjes në Panairin Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”.

5. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Turizmit, në nënshkrimin e kontratës, si “vend partner”, udhëhiqet nga tematika kryesore e panairit të turizmit, sipas çështjeve:

- a) Turizmi bregdetar;
- b) Turizmi i natyrës dhe i aventurës;
- c) Turizmi kulturor dhe historik.

6. Gjatë vitit 2016 paguhet shuma prej 58 400 (pesëdhjetë e tetë mijë e katërqind) eurosh, ku përfshihen pagesat si “vend partner”, për një pjesë të organizimit të *Press Trip* me pjesëmarrjen e gazetarëve të huaj si dhe për një pjesë të aktiviteteve përgatitore që do të organizohen gjatë ditëve të Panairit Ndërkombëtar “CMT, Shtutgart 2017”. Shuma tjetër e organizimit të panairit prej 169 800 (njëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) eurosh do të paguhet gjatë vitit 2017.

7. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 86, datë 3.2.2016****PËR TRANSFERIMIN E SË DREJTËS
SË PRONËSISË SË SHOQËRISË
“QENDRA SPORTIVE” SHA, TIRANË,
ME KAPITAL 100 PËR QIND
SHTETËROR, NGA MINISTERIA E
ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT,
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, TE
BASHKIA TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, dhe të neneve 3 e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shoqëria “Qendra sportive” sh.a., Tiranë, me kapital 100 për qind shtetëror, aktualisht në pronësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, transferohet në pronësi të Bashkisë Tiranë, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI**Edi Rama**

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve
Zyrtare Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 154 lekë